



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 153 Prot

Tiranë, më 14.10.2009

VENDIM Nr. 11 dt. 13.10.2009

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 13.10.2009, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara nga Këshilli Shkencor pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës:

VENDOSI:

Të miratojë projektet;

1. Paketa e ndërhyrjeve restauruese që do të realizohen me fondin e mirëmbajtjes nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Gjirokastrër:
 - Pazari, rruga Hazmurat.
 - Pazari rruga Hazmurat- Vitrinë (Xhixhi Mirka)
 - Rruga për në obelisk ish biblioteka
 - Ish Këndi i kuq
 - Banesa e Zekateve
 - Rruga Hazmurat , shtresë kapak guri i skuadruar në trotuare
 - Objekti ish magazine e mishit
 - Rruga DRKK-Fantazia
 - Ish lavanteria
 - Rruga për në Obelisk, shtresë me kapakë guri të zinj.
 - Banesa Babaramo
 - Banesa Ciu
 - Banesa Mehmet Balaj
 - Banesa Haderaj
 - Banesa Reshat Angoni
2. Projekti i restaurimit të Kullës së Sahatit të xhamisë Et'hem Beut, Tiranë. (Miratohet pjesa shtesë e projektit, e cila financohet nga Ambasada Amerikane në Shqipëri).

3. Projekt ide: "Vlerësimi dhe kontrollimi i trashëgimisë materiale të Beratit". (Projekti u miratua në parim. Pritet të shqyrtohet në KKR, projekti i zbatimit).
4. Projekti i ndërhyrjeve restauruese në banesën e familjes Kazani Tiranë.
5. Miratohet ndryshimi i zërit të punimeve për mbulesën e çatisë të objekteve Zigai dhe hotel Argjiro Gjirokastër, nga konstruksion çatie me rrasa guri, në restaurim çatie me konstruksion dhe mbulesë me tjegulla marsejeze.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
F E R D I N A N D X H A F E R R I

SEKRETAR I KKR
PROF. DR. VALTER SHTYLLA